



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

Legjislatura VI  
*Sesioni vjeshtor*

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.37/2018

Prishtinë, më 3 dhjetor 2018

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Mirjeta Kalludra, Mexhide Mjaku-Topalli, Luljeta Veselaj-Gutaj, Shemsi Sylja, Teuta Haxhiu dhe Veton Berisha.

Munguan: Lirije Kajtazi, Sasha Milosavljeviq, Saranda Bogujevci dhe Fisnik Ismaili.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Sadete Demaj-ZQM, Merita Sylja-IAP, Flora Kryeziu-UNICEF, Teuta Prekazi-UN HUMAN RIGHTS, Halil Kurmehaj, Dorunitina Bytyqi, Festim Krasniqi dhe Nazmi Sejfullahu- Inciativa e Pavarur e të Verbërve, Donika Ahmeti-MBPZHR, Besnik Morina-Hanndikos dhe Zana Ulaj, praktikante.

**Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e komisionit.**

Anëtarët e komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e komisionit, andaj komisioni i zhvilloi punimet me këtë,

**Rend dite:**

- 1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara;**
- 2. Diskutim lidhur me shënimin e datës 3 Dhjetor - Dita Ndërkombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara. Të ftuar përfaqësues nga: Zyra për Qeverisje të Mirë, Institucioni i Avokatit të Popullit dhe Shoqatat e Personave me Aftësi të Kufizuara;**
- 3. Të ndryshme.**

## **1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të kaluara**

Kryetarja konstatoi se procesverbalet, e mbledhjeve të mbajtura më 4 korrik dhe 22 tetor 2018, u miratuan pa vërejtje.

## **2. Diskutim lidhur me shënimin e datës 3 Dhjetor - Dita Ndërkombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara. Të ftuar përfaqësues nga: Zyra për Qeverisje të Mirë, Institucioni i Avokatit të Popullit dhe Shoqatat e Personave me Aftësi të Kufizuara**

**Kryetarja** tha se sot është Dita Ndërkombëtare për Persona me Aftësi të Kufizuara. Ne jemi këtu për të diskutuar se çka kemi bërë dhe çka duhet të bëjmë për personat me aftësi të kufizuara. Ne, si Komision për të Drejtat e Njeriut, kemi pasur shumë aktivitete dhe jemi munduar që të ndihmojmë në këtë drejtim.

Nga ana e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale është duke u bërë një draft- koncept për ligjin gjithëpërfshirës për personat me aftësi të kufizuara.

**Luljeta Veselaj-Gutaj** tha se para pak ditësh e kemi pasur një takim me përfaqësuesit e personave me aftësi të kufizuara, kemi ftuar ministrin e Arsimit, zëvendësministrin e Kulturës dhe kemi diskutuar për problematikat me të cilat ballafaqohen personat me aftësi të kufizuara. Po ashtu si komision kemi bërë monitorimin e ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe kemi pa cenimin që u bëhet personave me aftësi të kufizuara. Ajo që është e theksuar dhe që e kemi potencuar si komponent të veçantë është çështja e punësimit që është e paraparë me ligj dhe që nuk po zbatohet, ne po merremi më shumë përkushtim që të fuqizojmë zbatimin e ligjit në nivel vendi, si në nivelin qendror, po ashtu edhe në nivelin lokal.

**Teuta Haxhiu** theksoi se konsideron që ligji duhet të përfshijë gjithçka dhe uroi që në këtë paketën e ligjit, nuk do të ketë nevojë që çdo person të kërkojë edhe një akt tjetër nënligjor. Kur po parashihet nxjerrja e shumë udhëzimeve administrative, më duket si një mos marrje e përgjegjësisë nga askush. Prandaj, kisha dashur që çdo 3 Dhjetor të kemi rezultate të arritura, jemi këtu pikërisht për të bërë diçka bashkërisht, pra, presioni duhet të jetë i dyanshëm në mënyrë që të arrihet rezultati të cilin ne po e synojmë. Pra, edhe njëherë, ju them që të jemi bashkë dhe të ecim tutje me kërkesat tona dhe me përmbushjen e kërkesave që nuk mund të themi që mund t'i arrijmë 100% , por ato t'i shtyjmë aq sa mundemi.

**Shemsi Sylja** tha se ne nuk jemi të kënaqur me nivelin e përkujdesjes shtetërore ose institucionale për këtë kategori dhe të gjitha qeveritë e pasluftës, meqenëse kanë bërë përpjekje të jashtëzakonshme duke krijuar legjislacion të nevojshëm, por në praktikë mungon ende një kujdes i veçantë ose kujdesi i domosdoshëm ose i duhur që të kenë një përkrahje të nevojshme kjo kategori e njerëzve. Besoj dhe shpresoj që në të ardhmen do të jemi gjithnjë më të angazhuar dhe të kërkojmë sa më shumë përgjegjësi nga ana e institucioneve kompetente. Shpresoj që viti 2019 do të jetë vit i realizimit të shumë synimeve që i kemi në kuadër të komisionit, por edhe përgjithësisht edhe ju si përfaqësues të kategorive të personave me aftësi të kufizuara.

**Mirjeta Kalludra** tha se së fundi kemi qenë pjesë edhe e grupit punues për monitorimin e ligjit për mbrojtje nga diskriminimi, gjë të cilën gjatë vizitave nëpër komuna kemi parë që ka ngecje të madhe në zbatimin e ligjit. Sa i përket këtyre personave, vlen të ceket edhe punësimi për kategorinë e njerëzve, ashtu siç e parasheh ligji për këta persona, mirëpo kjo nuk po gjen zbatim. Uroj që në të ardhmen të ketë më shumë përgjegjësi institucionale, sepse kjo kategori ka nevojë për përkrahje nga ana institucionale dhe nga ana e gjithë shoqërisë, duke uruar që 3 Dhjetori i vitit të ardhshëm të na gjej më mirë në zbatimin e të gjitha ligjeve që kanë të bëjnë me personat me aftësi të kufizuara dhe ne, si komision, do të jemi në përkrahjen e këtyre personave.

**Mexhide Mjaku-Topalli** theksoi se vendi ynë në vazhdimësi ka punuar dhe është fokusuar në kompletimin e legjislacionit, në mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Duhet të bëjmë përpjekje bashkërisht që draft- ligji gjithëpërfshirës për personat me aftësi të kufizuara të na vij sa me shpejt në Kuvend.

Ne e dimë se kemi mundësi ta rishikojmë legjislacionin paraprak, mirëpo çështja është që gjithëherë po kemi ngecje, qoftë në zbatimin e ligjeve përkatëse, sidomos lidhur me çështjen e punësimit të kësaj kategorie. Po ashtu, ligji për të drejtat dhe statusin e personave tetraplegjikë dhe paraplegjikë nuk po gjen zbatim sa u përket afrimit të disa shërbimeve që i parasheh ligji. Dëshiroj të di nga ZQM ndërmarr për data bazën, a është duke punuar në këtë drejtim nëpër komuna apo në kuadër të qeverisë që të dihet saktë numri i personave me aftësi të kufizuara.

Ne e dimë që në disa institucione është punuar për të pasur qasje personat me aftësi të kufizuara, por kemi pengesa të mëdha, sidomos në teatro, në muze, në shërbime kulturore dhe në institucionet e tjera. Ne duhet të bashkëpunojmë më shumë për t'i plotësuar kërkesat e personave me aftësi të kufizuara.

**Merita Syla** tha se në Kosovë ekziston një kornizë e mirë ligjore për aftësinë e kufizuara, megjithatë është shumë e dhimbshme çështja e zbatimit të këtij legjislacioni, por gjithashtu edhe çështja gjithëpërfshirëse e aftësisë së kufizuara me legjislacionin që është në fuqi. Ka kategori të aftësisë së kufizuara që kanë mbetur jashtë ligjit për të drejtat e tyre, këtu po flas konkretisht për të shurdhrit, do të thotë të shurdhrit nuk janë të përfshirë në legjislacionin ku i gëzojnë të drejtat dhe benifitet e tyre.

Ne kemi menduar dhe kemi rekomanduar që së paku institucionet të afrojnë shërbime për personat e shurdhët, se paku të kenë të punësuar një person të gjuhës së shenjave dhe jo të kërkojnë interpretues të cilët janë mobil. Megjithatë edhe te gjuha e shenjave është problem edhe çështja e shkollimit të tyre në mënyrë që të afrohet mundësi e mjaftueshme të interpretuesve të gjuhës së shenjave nëpër institucionet ku ata kanë nevojë.

Ligji për arsim parasheh gjithë përfshirje të fëmijëve me aftësi të kufizuara nëpër shkolla, ndërsa as kushtet minimale për qasje nuk i kanë, janë dy- tri shkolla të reja, të cilat afrojnë qasje fizike fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Çështja e pensioneve, u ndalet njërit pension ndërsa u jepet tjetrit, çështja e pensionit kontribut pagues është e drejta në pronë, çështja e pensionit për personat me aftësi të kufizuara është që i jepet për një aftësi të kufizuara, një përkrahje monetare dhe tash do të thotë duhet t'i ndalim njërin pension.

Avokati i Popullit ka bërë një raport me rekomandime për çështjen e pensioneve dhe i ka rekomanduar Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, se kjo çështje është shkelje e të drejtës në pronë, në qoftë se i ndërpritet pensioni kontribut pagues. Mirëpo akoma nuk kemi

marrë ndonjë përgjigje lidhur me zbatimin e rekomandimeve të nxjerra nga ana e Avokatit të Popullit.

**Rukije Gashi** tha se kanë pasur një takim me Ministrinë e Arsimit dhe se kanë marrë premtim që në vitin 2019 do të punësohen 3 asistentë në shkollën e Prizrenit dhe pritet të shihet se sa do të mbahet premtimi. Po ashtu, tha se kanë një bashkëpunim me Zyrën e Qeverisjes së Mirë dhe se zyrtarizmi i gjuhës së shenjave ka ndodhur në 2010, lajmet në gjuhën e shenjave i kemi. Në Kosovën janë 16 interpretues të gjuhës së shenjave, problemin më të madh e kemi me Gjakovën dhe në qytete më të mëdha sepse nuk kemi interpretues të mjaftueshëm dhe se pritet që edhe dy grupe të licencohen.

Po presim prej Zyrës për Qeverisje të Mirë që të marrin iniciativa për Projektligjin e gjuhës së shenjave. Rregullorja është duke funksionuar mirë, por të them të drejtën jemi shumë mbrapa me pagesat, sepse paguhemi prej Qeverisë së Kosovës.

Sa për njohuri, them të drejtën në Ballkan ne jemi pak më mirë se shtetet e tjera për komunitetin e shurdhët. Gjuha e shenjave është zyrtarizuar e para në Kosovë dhe ne kemi qenë iniciator që qeveria jonë dhe komiteti i të shurdhëve që të zyrtarizohet gjuha e shenjave edhe në Shqipëri. Komiteti i të shurdhëve është larguar në vitin 2013, krejtësisht nga sistemi për pensionet.

**Sadete Demaj** Jemi dëshmitarë që Kosova e ka avancuar dukshëm kornizën ligjore institucionale dhe politikave sa i përket mbrojtës dhe promovimit të drejtave të njeriut në përgjithësi. Mirëpo kemi ngecje gjate zbatimit në mungesë të buxhetit, në mungesë të ekspertizës të personave që janë të thirrur që t'i zbatojnë ato politika. Fatkeqësisht nganjëherë qoftë edhe në mungesë të vullnetit politik. E kemi një ligj mjaft të avancuar i cili është në përputhje me parimet dhe standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të kësaj kategorie, mirëpo nganjëherë nuk po gjen zbatim, është përcaktuar shuma që duhet të përfitojnë personat me paraplegji dhe tetraplegji, 150 euro është shuma që marrin plus 150 euro merr edhe personi shoqëruar apo personi i ngushtë i familjes. Përveç kësaj edhe një shumë e vogël prej 75 euro paguhet për pajisjet shtesë, pra kjo ka qenë mundësia e qeverisë, mirëpo nuk do të thotë që kjo shumë adekuate i plotëson të gjitha nevojat.

Çdo institucion, varësisht prej shërbimeve që i afron, qoftë Ministria e Arsimit në fushën e arsimit, Ministria e Mirëqenies Sociale në fushën e mirëqenies sociale, Ministria e Shëndetësisë ata i posedojnë të dhënat se sa persona janë duke përfitur nga shërbimet që i afron institucioni apo ministria përkatëse. Ne, si Zyre për Qeverisje të Mirë, jemi të obliguar të përcjellim çështjen e afrimit të shërbimit në gjuhën e shenjave për personat që kanë probleme me të dëgjuarit, e kemi instaluar data bazën, i kemi të dhënat se sa persona brenda vitit janë përfitues të shërbimeve, sa orë shërbime për personat e shurdhët janë afuar gjatë vitit edhe sa ka ndarë qeveria për mbulimin e shpenzimeve për kategori të personave me aftësi të kufizuar. Të gjitha shpenzimet për sa i përket afrimit të shërbimeve për gjuhën e shenjave për interpretuesit që angazhohen i mbulon Zyra e Kryeministrit.

Shoqata e të Shurdhëve është e autorizuar që t'i sigurojë interpretuesit, çdo herë kur është e nevojshme për personin që ka nevojë për shërbime. Interpretuesit funksionojnë në kuadër të shoqatës, këta na e dërgojnë listën dhe në bazë të asaj liste ne e bëjmë procedimin.

**Halil Kurmehaj** tha se personat e verbër vazhdojnë të hasin në vështirësi sa i përket arsimit, qendrat e aftësimi profesional organizojnë kurse të ndryshme duke përfshirë edhe asistencën administrative, por a mundet një i verbër t'i kryej shërbimet administrative në qoftë se nuk janë të përgatitura në shkrimin brail ose në shkronja të zmadhuara.

Çështje tjetër që neve na brengos shumë është edhe çështja e librezave të verbërisë dhe Zyra e Kryeministrit për Qeverisje të Mirë ka marrë për obligim që ta zgjidhë këtë problem dhe kanë kaluar muaj të tërë që nuk është zgjidhur problemi. Kemi përshtypjen që kjo punë po neglizhohet dhe ne e kemi të regjistruar ku përfaqësuesit nga Zyra e Kryeministrit për Qeverisje të Mirë kanë deklaruar që kjo çështje zgjidhet menjëherë. Kërkoj prej juve deputetëve që të caktoni afate se kur mund të zgjidhet ky problem, nuk ka pengesa ligjore në këtë problem, i gjithë komuniteti i personave me aftësi të kufizuara ta kenë një librezë të unifikuar. Përderisa një OJQ e caktuar lëshon librezat të verbërisë me bekimin e shtetit dhe Zyrës së Kryeministrit për Qeverisje të Mirë.

Çështja tjetër që neve na brengos shumë është edhe çështja e transportit urban dhe ndërurban, në këtë çështje e kemi ngritur edhe te institucioni i Avokatit të Popullit, në po kërkojmë që të lëshohet një qarkore ku obligohen operatorët për të krijuar vende të rezervuara për personat e verbër dhe personat tjerë me aftësi të kufizuara.

Ne kemi bërë thirrje vazhdimisht sa i përket kornizës juridike në çështjen e arsimit. Ne po kërkojmë prej juve që të unifikoheni dhe të ushtroni presion qeveritarëve në mënyrë që njëherë e përgjithmonë çështja e arsimit të zgjidhet, të krijohen mundësi dhe të afrohen mundësi për personat e verbër që ky komunitet për personat e verbër të ketë alfabetin brail, literaturën në brail në shkollat e mesme dhe në fakultete. Kemi propozuar që të krijohet një qendër mbështetëse në kuadër të njërit nga universitetet publike. Ne kemi sugjeruar Universitetin Publik të Prishtinës. Çështja tjetër që po kërkojmë nga ju është që sa më shpejt që është e mundshme që brenda këtij viti transporti publik të sinjalizohet me zë.

Çështje tjetër që neve po na brengos shumë është çështja e përfshirjes së komunitetit të personave të verbër te fondet qeveritare. Ne kemi kërkuar nga Zyra e Kryeministrit qasje në fonde dhe ata kanë afuar, por në kurrë nuk është aprovuar një kërkesë e tillë.

Çështje tjetër që ne kërkojmë sa i përket sektorit të arsimit, që gjatë janarit ose shkurtit të organizojmë një vizitë të përbashkët ne ndonjërin nga vendet fqinje, përfshirë Malin e Zi, pse jo edhe Kroacinë dhe të shohim se si ata i kanë zgjidhur këto probleme.

**Mexhide Mjaku-Topalli** parashtrroi pyetje lidhur me të dhëna që janë duke munguar, a është ndarë buxhet për realizimin e këtyre çështjeve që të kenë qasje të gjithë personat e verbër dhe të shurdhët. Pyetja tjetër kishte të bënte me librezat, sepse edhe në mandatin e kaluar ka qenë ky problem, dhe prapë është ky problem i njëjtë. Presim përgjigjen nga ZQM-ja apo nga Zyra e Kryeministrit.

**Teuta Haxhiu** theksoi se çështja e librezave për mua është shumë shqetësuese, dhe meqë ZQM paska premtuar që kjo do të zgjidhet, është mirë të na njoftojnë se çka është bërë në këtë drejtim. Ajo tha se Ligjet që kanë shumë udhëzime administrative i konsideroj që janë jo të mira.

**Donika Ahmeti** Ju si komision për të drejtat e njeriut a jeni në dijeni që ligjet për persona me aftësi të kufizuara janë duke u shkelur dhe duke mos u zbatuar, dua që të interesoheni për të gjitha ligjet që janë për personat me aftësi të kufizuara dhe të mos anashkalohen.

**Luljeta Veselaj-Gutaj** tha se kemi diskutuar edhe më shumë persona të tjerë dhe ajo çka është në dobi është se çka mundemi ne me zgjidhur në drejtimin e infrastrukturës shkollore, por edhe përgatitjes edukativo arsimore.

**Shemsi Syla** Të gjitha këto çështje që u parashtruan janë shqetësuese. Ne, si anëtarë të Komisionit Funkcional, do t'i marrim dhe do ta ngrehim zërin që zbatimi i legjislacionit lidhur me këto kategori të gjej zbatim sa më të mirë.

**Halil Kurmehaj** tha se sa i përket librezave për personat e verbër zgjidhja konkrete është që administrate pensionale në të ardhmen me i lëshuar këto librezat.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

*E përgatiti:*

*Stafi mbështetës i komisionit.*

**Kryetarja e komisionit,**

---

**Duda Balje**